



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:032333

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06361677

Ac.nr.7915/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Hunaida Pasuli, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Lumni Sallauka anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.Sh. .B.M B.M dhe B.K përmes autorizimit i përfaqëson L. T. avokat në P., kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për kompensimin e shpenzimeve për ushqim, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.99/21, të datës 18.09.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria Komunale për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.99/21, i datës 18.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.99/21, të datës 18.09.2023, ka vendosur si vijon: *I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve B.Sh., B. M. B. M., dhe B. K. të gjithë nga V., dhe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë paditëses B.Sh. për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 11.03.2020 t'ia paguaj shumën prej 250.00 euro, paditëses B. M. për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 11.03.2020 t'ia paguaj shumën prej 250.00 euro, paditësit B. M. për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 11.03.2020 t'ia paguaj shumën prej 250.00 euro si dhe paditësit B. K. për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 11.03.2020 t'ia paguaj shumën prej 250.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë (19.02.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim që paditësve të ua kompensoj shpenzimet e procedurës, dhe atë, për padi shumën prej 260.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 280.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.*

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe çështjen ta vendos në mënyrë meritore ose aktgjykimin e atakuar të prish dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit B.Sh., B.M., B. M. dhe B. K., të gjithë nga V. përmes përfaqësuesit të autorizuar, me dt.19.02.2021 në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *‘Kur gjykata, pasi ti arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë’* Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë dispozitë ka administruar provat materiale dhe pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e shpenzimeve të ushqimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj ka nxjerrë aktgjykimin, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjyimit të atakuar. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marrë duke u bazuar në dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika e) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret kërkesëpadia e paditësve është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 87 të LPK përkatësisht kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor prej tre vitesh nga arritje e kërkesës për pagesë.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara drejt është vërtetuar gjendja faktike se paditëset janë në marrëdhënie pune me të paditurën, bazuar nga kontratat e punës dhe atë për paditësen B. Sh. kontrata numër ... /20, e datës 11.10.2018, për paditësen B. Sh. kontrata numër ... /20, e datës 29.09.2015, për paditësin B.M. kontrata numër .../20, e datës 18.01.2018, si dhe për paditësin B. K. kontrata e punës me numër.../20 e datës 29.09.2015. ndërsa në bazë të vërtetimeve të datës 28.10.2020, të lëshuar nga SHFMU “N. Zh.”, fshati S.i P., Komuna V. për paditësit B. Sh., B. M., B.M.dhe B. K. për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 11.03.2020, erdhi në përfundim se kërkesa e paditësve është e bazuar, andaj edhe se cilëve prej paditësve ia njohu shumën prej 250.00 euro, duke përlllogaritur një ditë pune me 2,00 euro (125 x 2 ë 250). Andaj duke u nisur nga fakti se e paditura paditësve nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të paraparë me dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata me të drejt ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është tërësisht e bazuar, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit e detyroi të paditurën që secilit paditës për ditët e prezencës në pune si në vërtetimet e lartcekura të ua paguaj shumën prej nga 2 euro për secilën ditë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 5 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë së paditësve, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes të së drejtës për të parashtruar kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadiisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko-civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit- shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragrafin 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Pretendimet ankimore të të paditurës se kërkesëpadia e paditësve është parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës dhe i mungon baza ligjore dhe se e njëjta është e pasafatshme sipas dispozitës së nenit 182.2 pika e) e LPK-së, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit e dt.18.04.2017, ka qenë në fuqi deri më datë 18.04.2020 dhe se pas kësaj date e njëjta nuk ka efekt juridik, mirëpo këto pretendime sipas gjykatës ankimore janë të paqëndrueshëm për faktin se në bazë të nenit 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017, është paraparë se *“Nëse nga Kontrata Kolektive pasi ti skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive, lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmujorin e parë përdoren rregullat dhe dispozitat e kontratës së vjetër”*, çka nënkupton që Kontrata Kolektive e Arsimit e dt.18.04.2017 ka pasur vlefshmëri, përkatësisht ka prodhuar efekt juridik për palët kontraktuese edhe pas datës 18.04.2020. Po ashtu, në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, (mendimi juridik për shpërblim jubilar dt.27.02.2023, faqja 2, parag.IV), parashihet se: *“Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), (në tekstin e më tejme: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017) aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017-21.01.2021”*, ndërsa Kontrata e re Kolektive e Arsimit në Kosovë, ka hyrë në fuqi nga data 22.01.2021. Në këtë kontekst nuk pranohet pretendimi i të paditurës për paafatshmërinë e padisë dhe rrjedhimisht as për parashkrimin e kërkesës, konform dispozitave të nenit 87 të Ligjit të Punës, e që në këtë rast nuk ka kaluar ky afat, pasi që paditësit me padi ka kërkuar që ti kompensohen shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore prej datës 01.09.2019, e deri me datë 11.03.2020, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë me datë 19.02.2021, do të thotë ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për periudhën sa ka qenë në fuqi Kontratën Kolektive e Arsimit dhe brenda afatit prej tre viteve nga kur i ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifën për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.7915/2023, me datë 22.10.2024

Numri i lëndës: 2021:032333
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06361677

Kryetare e Kolegjit
Hunaida Pasuli